



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Drejtoria për Shërbime Publike



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA GRAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 4212 Mb. 30.12.25
Br. prot. Dt. 30.12.25
RAHOVEC - GRAHOVAC

PLAN I PUNËS

2026

Punuar në nëntor, 2025

PËRMBAJTJA

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE.....	1
Prioritetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike	1
Tremujori i parë: janar, shkurt, mars.....	1
Tremujori i dytë: prill, maj, qershor	2
Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator	3
Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor.....	3
Synimet e DSHP-së	4

Drejtoria për Shërbime Publike

Drejtoria për Shërbime Publike për vitin 2026 planifikon rritjen e investimeve në infrastrukturë publike, në ndërtimin e rrugëve lokale, zgjerimin e rrjeteve të kanalizimeve fekale si dhe trajtimin e tyre përmes gropave septike (bio septike) mirëmbajtjen e hapësirave publike si dhe investimeve tjera të nevojshme që janë prioritet për qytetarët e komunës sonë.

DSHP këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes:

- Implementimit të projekteve kapitale në infrastrukturë publike, në rrugë, në eficiencë të ndriçimit publik dhe në mirëmbajtje, në zgjerim të rrjeteve të ujërave fekale dhe atmosferike, në trotuare si dhe në projekte tjera në interes të qytetarëve,
- Mirëmbajtjes së rrugëve, gjatë dy sezoneve,
- Mirëmbajtjen e hapësirave publike, parqeve, varrezave, lapidarëve, si dhe projekteve tjera që janë implementuar dhe kanë nevojë për mirëmbajtje,
- Implementimin e disa projekteve që janë bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës, MPL-së, MMPH-së si dhe grantet e fituara nga donatorë të ndryshëm si dhe nga granti i performancës si dhe grante nga fondet e IPA-së

Prioritetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, si dhe në planifikimin e bërë nga Drejtoria për investime publike, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

- Pastrimin e rrugëve dhe trotuareve nga bora dhe intervenimet e tjera emergjente (Janar-Shkurt-Mars 2026);
- Ndërtime dhe intervenime sipas nevojës në infrastrukturë (Janar-Shkurt-Mars 2026)
- Heqjen e deponive ilegale të inerteve(Gjatë tërë vitit 2026);
- Analizimin e kontratave dhe përmbushjen e tyre në projektet si: trotuare, rrugë, rrethotullime, hapësira publike, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, të

- martirëve, të civilëve, po ashtu, të shesheve, pllakave përkujtimore, të hapësirave të gjelbëruara etj. (Gjatë tërë vitit 2026);
- Vazhdimin e projekteve të reja për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimit, të rrugëve, trotuareve, etj, (prill-tetor 2026)
- Mbledhja e të hyrave nga sipërfaqet publike sipas rregullores së DSHP-së (gjatë tërë vitit 2026);
- Mirëmbajtjen e rregullt të kanaleve të ujërave fekale nga kompania KRU-Gjakova si dhe investime të reja në ndërrim të gypave të ujit, zgjerime në ujësjellës dhe investime të reja në bashkëfinancim me komunën;
- Rikonstruimin dhe riasfaltimin e rruges Rahovec-Drenoc e deri në Sarosh, projekt i bashkefinancuar nga Ministria e Infrastrukturaes.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

- Ndërtimin e rrugëve në qytet dhe fshatrat e komunës sipas prioriteteve dhe planit të prokurimit (2026);
- Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe ndërhyrjet emergjente në disa vendbanime të komunës së Rahovecit (2026);
- Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e gropave septike dhe ndërhyrjet emergjente në disa vendbanime të komunës së Rahovecit (2026);
- Ndërtimin e trotuareve në qytet dhe fshatrat e komunës sipas prioriteteve (Gjatë tërë vitit 2026);
- Vazhdimin e projektit me furnizimin me ujë të pijshëm për zonën e III-të në Rahovec duke përfshirë fshatrat, Hoqë e Madhe, Zoqisht dhe Opterushë, zona ekonomike, pastaj fshatrat Zatriq, Mrasor dhe Kaznik në bashkëfinancim me KRU Gjakovën, mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe atyre në qytet, muret mbrojtëse sipas prioriteteve etj;
- Vazhdimin e punimeve në rrugën Sapniq-Nashpall-Vrajak,
- Fillimin e punëve me projektin për sinjalizim horizontal dhe vertikal të rrugëve (Gjatë tërë vitit 2026);
- Vendosjen e disa pengesave në rrugë sipas standardeve të përcaktuara;
- Inicimin, analizimin e madhësisë dhe dendësisë së qarkullimit në rrugët e qytetit për verifikimin e senseve të lëvizjes;
- Digjitalizimin e infrastruktures publike;
- Vendosja e tabelave digjitale të trafikut;
- Krijimin e shtigjeve të reja për biçikleta dhe këmbësorë në zonën urbane;
- Krijimin e infrastrukturës së nevojshme për personat me nevoja të veqanta;

- Në bashkëpunim me policinë e Kosovës dhe kompaninë për autobartje të veturave, do të ketë angazhim gjatë gjithë vitit 2026.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

- Vazhdimin e projektit të ndërtimit të rrugës 4 korsi Rahovec-Xërxë, fazën përfundimtare;
- Vazhdimin e ndërtimit të rrugëve lokale qytet dhe në të gjitha vendbanimet e komunës sonë;
- Vazhdimin dhe përfundimin e ndërtimit të 15 segmenteve rrugore në qytet, bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës,

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

- Menaxhimi i deponive për mbeturina nga demolimet dhe ndërtimet;
- Eliminimin e të gjitha deponive ilegale- inerteve;
- Në bashkëpunim me KEDS do të caktojmë prioritet për shtrirjen e rrjetit elektrik si dhe vendosjes së trafave sipas kërkesave të qytetarëve;
- Në bashkëpunim me KRU Gjakoven do të implementojmë projekte kapitale në zgjerimin dhe ndërtimin e gypave për ujë të pijshëm,
- Përmbylljen e disa projekteve kapitale,
- Përgatitjen në fund-vit për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror,
- Raportin vjetor të drejtorisë, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të drejtorisë për vitin që vjen!

Performanca komunale dhe indikatorët e shërbimeve publike

6 fusha dhe 23 tregues janë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike



Fusha 8; Hapësirat Publike, janë 3 tregues, në përqindje prej (48.99, 84.16 dhe 81.71 %), totali 71.62 %, **ndërsa synimi është në rritje në përqindje totale deri 90%,**

Fusha 9; Infrastrukturë rrugore, janë gjithsej në këtë fushë 7 tregues, përmirësime kemi në shtigjet urbane të biçikletave, është rritur përqindja në krahasim me vitin paraprak 72.38%, **ndërsa synimi është në rritje në përqindje totale deri 80 %,**

Fusha 10; Transporti publik, janë 3 tregues, në këtë fushë kemi 100 %, **synimi është të jete poashtu 100%**

Fusha 11.1; Uji i pijshëm, 2 tregues janë gjithsej, ku komuna jonë mbulohet me 100 % të mbulueshmërisë së territorit, **synimi i njejtë është që ky tregues të jete 100 %**

Fusha 11.1.2; Kanalizimi, në këtë fushë janë gjithsej 3 tregues, dy tregues janë 100 % ndërsa treguesi i tretë që i përket impiantit të ujërave të zeza është i ngrirë për shkak kostove të mëdha që kanë këto projekte, **synimi i njejte eshte qe ky tregues te jete 100 %**

Fusha 11.1.3; Menaxhimi i mbeturinave, jane gjithsej 5 tregues në këtë fushë, komuna jonë është duke realizuar në tërësi planin në menaxhim të mbeturinave, sfidë mbetet taksa për mbeturina që parashihet të filloj nga viti 2024, ku pritët të implmentohet në komunë si takes, 100%

Synimet e DSHP-së

Përkushtim i veçantë i DSHP-së do të jetë përmirësimi i infrastrukturës publike për qytetarët e komunës sonë. Në kuadër të infrastrukturës parashihet që kujdes i shtuar do të jetë te:

- Trajtimi i ujërave atmosferik në qytet dhe fshatra te komunës sonë,
- Infrastruktura publike në rrjetin e kanalizimeve fekale dhe gropave septike, zgjerimet,
- Ndërtimi i rrugëve lokale, trotualet dhe mirëmbajtja e hapësirave publike,
- Digjitalizimi i infrastrukturës publike,
- Vendosja e panelave solare në institucione publike si dhe ne zvogëlim të shpenzimeve të energjisë përmes platformave tjera digjitale.

Drejtoria për Shërbime Publike